

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE, QERSHOR, KORRIK DHE GUSHT 2026

Nr. Rendor	Data e kërkesës	Objekti i kërkesës	Data e përgjigjes	Përgjigje	Mënyra e përfundimit të kërkesës	Tarifa
1	2.6.2026	Në bazë të ligjit nr. 10 454, datë 21.7.2011 "Për transplantimin e indeve, të qelizave dhe të organeve në Republikën e Shqipërisë", neni 21, pika 2, përcaktohet akti nënligjor për miratimin e kritereve mjekësore për provimin e vdekjes. A është miratuar ky akt? Nëse po, kërkohej një kopje e tij.	2.6.2026	Deleguar Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, referuar nenit 12, pika 2, të ligjit nr 119/2014 "Për të drejtën e informimit", i ndryshuar, sepse bazuar në nenin 35 të ligjit nr. 10 454, datë 21.7.2011 "Për transplantimin e indeve, të qelizave dhe të organeve në Republikën e Shqipërisë", ngarkohet Ministri i Shëndetësisë që, pas hyrjes në fuqi të ligjit, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të nenit 21 pika 2 të këtij ligji.	Deleguar	Nuk ka
2	10.6.2026	A mund të më informoni ju lutem nëse Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës i ka kërkuar tashmë Shqipërisë të paraqesë një listë me tre gjyqtarë të rinj në GJEDNJ? Nëse po, brenda cilit afat kohor? Nëse jo, kur do të dërgohet afërsisht kjo ftesë?	15.6.2026	Deleguar Avokaturë së Shtetit, referuar nenit 12, pika 2, të ligjit nr 119/2014 "Për të drejtën e informimit", i ndryshuar.	Deleguar	Nuk ka
3	23.6.2026	Kërkohej informacion nëse është në fuqi vendimi nr.680, datë 22.10.2004 i Këshillit të Ministrave "Për shpalljen e sistemit ligatitor Vjosë-Nartë, peisazh ujqor/tokësor i mbrojtur".	24.6.2026	Deleguar Ministrisë së Mjedisit, referuar nenit 12, pika 2, të ligjit nr 119/2014 "Për të drejtën e informimit", i ndryshuar.	Deleguar	Nuka ka
4	8.7.2026	Kërkohej informacion mbi udhëtimet e kryera jashtë shtetit, të Kryeministrit për periudhën 2025-korrik 2026, destinacionin, datat, qëllimin e vizitës dhe përbërjen e delegacionit, shpenzimet totale për secilin udhëtim, të ndara sipas transportit, akomodimit, dietave dhe shpenzimeve të tjera. Nga cili fond buxhetor janë mbuluar këto shpenzime? Kërkohen raportet e përgatitura pas kthimit nga secili udhëtim, nëse janë hartuar.	19.8.2026	Në përgjigje të kërkesës për informacion, informohet se bazuar në ligjin 119/2014 "Për të drejtën e informimit", ky ligj rregullon të drejtën e njohjes me informacionin që prodhohet ose mbahet nga autoritetet publike, por nuk sanksionon detyrim të autoritetit publik për të përgatitur analiza, statistika, relacione, për t'ju përgjigjur pyetjeve etj. Sa më sipër, bazuar në nenin 3, pika 3 e ligjit 119/2014 "Për të drejtën e informimit", ku përcaktohet se: "Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentit", kërkesa për informacion duhet të saktësojë dokumentin zyrtar që nevojitet. Të dhënat që lidhen me udhëtimet, destinacionet, datat, qëllimin e udhëtimit dhe përbërjen e delegacioneve administrohen dhe evidentohen në dokumentacionin zyrtar të udhëtimeve dhe në dokumentacionin përkatës të aktivitetit zyrtar të Kryeministrit. Për Kryeministrin, si subjekt i trajtimit të veçantë ceremonial, referenca ligjore, specifike është VKM nr. 420, datë 8.6.2016, "Për miratimin e Ceremonialit Zyrtar të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar. Shpenzimet e udhëtimeve të Kryeministrit për biletat e udhëtimit, akomodimin, dietat dhe shpenzimet e tjera përballohen nga fondet e parashikuara në buxhetin e institucionit, në përputhje me klasifikimin buxhetor dhe destinacionin e shpenzimit. Dokumentacioni dhe raportimet pas udhëtimeve administrohen në përputhje me rregullat përkatëse të administrimit të dokumentacionit zyrtar dhe menaxhimit financiar.	Përfunduar	Nuka ka
5	20.7.2026	Kërkohen të dhëna që mund të kete shteti lidhur me database mbi: Numrin e saktë të refugjatëve të strehuar / trajtuar në Shqipëri Shpërndarjen e saktë demografike (sipas moshës dhe gjinisë). Statistikat e detajuara të kampeve kryesore në Shqipëri. Dhe çdo e dhënë tjetër statistikore dhe nëse ekzistojnë, edhe emërore (Maqedonia e Veriut psh ka të dhëna emërore që me kolegët e historisë i kemi përdorur për të krijuar një muze nderimi e përkujtimi për 1999, elementë që në Shqipëri ende mungojnë.	30.7.2026	Informohet se: Dokumentet e vitit 1999, që kërkohen, përbëjnë dokumente me rendësi historike kombëtare (RHK), e si të tilla të gjitha dokumentet RHK të vitit 1999 janë dorëzuar në Arkivin Qendror Shtetëror pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave. Lidhur me dokumentet me vlerë ruajtje të përkohshme, që ndodhen në arkivin e Kryeministrisë, ato janë në proces përpunimi tekniko shkencor. Nëse do të gjenden dokumente me vlerë, lidhur me sa keni kërkuar, do t'ju vendosim në dispozicion. Bashkëlidhur do të gjeni disa të dhëna të nxjerra nga katalogu online i Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave.	Përfunduar	Nuka ka

6	23.7.2026	Kërkohet informacion mbi një deklaratë të Kryeministrit, të bërë në 3 qershor se SPAK kishte vendosur t'i mbante fondet të ngrira. Cila është baza ligjore që u bllokuan llogaritë e investitorëve të huaj?	24.7.2026	Informohet se ligji 119/2014 "Për të drejtën e informimit" rregullon të drejtën e njohjes me informacionin që prodhohet ose mbahet nga autoritetet publike, por nuk sanksionon detyrim të autoritetit publik për të përgatitur analiza, komente, për t'ju përgjigjur pyetjeve etj. Sa më sipër, bazuar në nenin 3, pika 3 e ligjit 119/2014 "Për të drejtën e informimit", ku përcaktohet se: "Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit original ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentit", kërkesa për informacion duhet të saktësojë dokumentin zyrtar që nevojitet.	Përfunduar	Nuk ka
7	24.7.2026	Kërkohet informacion dhe dokumentacion mbi iniciativën, përzgjedhjen, miratimin dhe zbatimin e projektit "Smart city" në Shqipëri.	29.7.2026	Deleguar Ministrisë së Punëve të Brendshme, referuar nenit 12, pika 2, të ligjit nr 119/2014 "Për të drejtën e informimit", i ndryshuar.	Deleguar	Nuk ka
8	5.8.2026	Kërkohet informacion në lidhje me mundësinë e rinovimit të kontratës si sanitare me kontratë 4-orëshe përmes Zyrës së Punës.	6.8.2026	Deleguar Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive, referuar nenit 12, pika 2, të ligjit nr 119/2014 "Për të drejtën e informimit", i ndryshuar.	Deleguar	Nuka ka
9	14.8.2026	Kërkohet informacion, për aplikim, për kredi të lehtësuar për strehim për të punësuarit përfitues në varësi të Ministrisë së Arsimit.	17.8.2026	Deleguar Ministrisë së Arsimit, referuar nenit 12, pika 2, të ligjit nr 119/2014 "Për të drejtën e informimit", i ndryshuar.	Deleguar	Nuka ka
10	17.8.2026	Kërkohet informacion, për aplikim, për kredi të lehtësuar për strehim për të punësuarit përfitues në varësi të Ministrisë së Arsimit.	18.8.2026	Deleguar Ministrisë së Arsimit, referuar nenit 12, pika 2, të ligjit nr 119/2014 "Për të drejtën e informimit", i ndryshuar.	Deleguar	Nuka ka
11	20.8.2026	Kërkohet informacion, për aplikim, për kredi të lehtësuar për strehim për të punësuarit përfitues në varësi të Ministrisë së Arsimit.	21.8.2026	Deleguar Ministrisë së Arsimit, referuar nenit 12, pika 2, të ligjit nr 119/2014 "Për të drejtën e informimit", i ndryshuar.	Deleguar	Nuka ka
12	27.8.2026	Sa platforma online të krijuara nga Qeveria Shqiptare për komunikimin, konsultimin, pjesëmarrjen dhe ndërveprimin e qytetarëve me qeverinë dhe institucionet publike janë ngritur që prej vitit 2013? Ju lutem të specifikoni emrin dhe vitin e krijimit të secilës platformë. Sa prej këtyre platformave janë ende funksionale (emrat) dhe sa janë mbyllur? A ka raste kur një platformë e krijuar më parë është riemërtuar ose është përfshirë në një platformë tjetër, duke ruajtur të njëjtin funksion apo shërbim për qytetarët? Nëse po, ju lutem të specifikoni të gjitha rastet.	28.8.2026	Informohet se ligji 119/2014 "Për të drejtën e informimit" rregullon të drejtën e njohjes me informacionin që prodhohet ose mbahet nga autoritetet publike, por nuk sanksionon detyrim të autoritetit publik për të përgatitur analiza, statistika, për t'ju përgjigjur pyetjeve etj. Sa më sipër, bazuar në nenin 3, pika 3 e ligjit 119/2014 "Për të drejtën e informimit", ku përcaktohet se: "Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit original ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentit", kërkesa duhet të saktësojë dokumentin zyrtar që nevojitet.	Përfunduar	Nuk ka
13	31.8.2026	Kërkohet informacion mbi bazën ligjore dhe procedurën që duhet të ndiqet për të dhënë provimet e mbartura dhe për të përfunduar studimet. Nëse rifillimi i studimeve nuk është i mundur, cila është rruga tjetër që parashikohet për raste të tilla.	31.8.2026	Deleguar Ministrisë së Arsimit, referuar nenit 12, pika 2, të ligjit nr 119/2014 "Për të drejtën e informimit", i ndryshuar.	Deleguar	Nuk ka